



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 338, datë 19.4.2017

P Ë R

**KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
TE BASHKIA FINIQ, TË PRONËS NR.646, ME EMËRTIM “ISH-
GRUP ARTILERI TOKËSORE”, ME VENDNDODHJE
NË KRANE, FINIQ, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Finiq, të pronës nr.646, me emërtim “Ish-grup artileri tokësore”, me vendndodhje në Krane, Finiq, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një qendre të shërbimeve publike dhe për vendosjen e shërbimit zjarrfikës, MZSH, për realizimin e funksioneve të veta e të shërbimeve në territorin që përfshin Bashkia Finiq.
2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr.646, me emërtim “Ish-grup

artilери tokësore”, me vendndodhje në Krane, Finiq, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave paluajtshme shtetërore publike, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Finiq.

3. Bashkisë Finiq i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr.646, me emërtim “Ish-grup artileri tokësore”, me vendndodhje në Krane, Finiq, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Finiq për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I MBROJTJES

MIMI KODHELI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

PETRO KOÇI




NR.PROT.1372/4
DATE 19.4.2017


MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
AGJENCISË SË INVENTARIZIMIT DHE TRANSFERIMIT
TË PRONAVE PUBLIKE
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME
BASHKISË FINIQ
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Engjëll Agaçi', is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' and 'MINISTRI I TREGTISË DHE SIPËRMARRJES' around a central emblem.



PLAN RILEVIMI

Prona nr.646 REP. USHT. GR.AT. KRANE DELVINE

MIRATOHET
Komandant Komandes Mbështetëse
Kolonel ARKLAJ BALI



DREJTORI I IGJIU
N/Kol. Ark. FERDI HYRAJ




PUNOI
Ing. Ermal MAÇI

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 2264
Nr.Pasurise _____ Vol. _____ Fq _____
Indeksi i Hartes J-34-5-(67-D),(83-B)
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurise DELVINE
Q/F KRANE DELVINE
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes,Komanda Mbështetëse

Nentor 2016

Shpjeguese:
Sip e pergjithshme=20007 m2
Siperfaqe ndertimi=2370.35m2
— Kufiri i Repartit



Shënim : Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Komandes Mbështetëse nr.6115, datë 07.09.2016, bazuar në kufijtë faktik të pronës të treguar nga përfaqesuesi i KM, hedhur mbi ortofoton dhe kundrin e bashkimit të HTR të dhënë nga ZQRPP, Tirane.